



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

ZLAnr.71/2025

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Kujtim Pasuli kryesues, Hidajete Gashi Alaj dhe Ramush Bardiqi anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e Subjektit Politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, paraqitur kundër Subjektit Politik Për Drenasin Kampion me Ramiz Lladrovcin, me seli në Drenas, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, gjatë fushatës zgjedhore për Zgjedhjet Lokale 2025, që do të mbahen me datën 12 Tetor 2025, në seancën e panelit të mbajtur më datë 29.09.2025, merr këtë:

VE N D I M

REFUZOHET e pabazuar ankesa ZL.Anr.71/2025, e datës 27.09.2025, parashtuar nga Subjektit Politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, paraqitur kundër Subjektit Politik Për Drenasin Kampion me Ramiz Lladrovcin, me seli në Drenas, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët gjatë fushatës zgjedhore për Zgjedhjet Lokale, që do të mbahen më datë 12 Tetor 2025.

A r s y e t i m

Me datën 27.09.2025 PZAP-i, ka pranuar një ankesë nga Subjekti Politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, në të cilën pretendohet se më datë 26 shtator 2025, Mentor Gashi, mbështetës i subjektit politik PDKRL, ka postuar një njoftim për takime me kandidatin e këtij subjekti politik, Ramiz Lladrofcin.

Sipas parashtresës të ankesës Mentor Gashi, është drejtor në shkollën "Bajram Curri" në fshatin Nekoc, komuna e Drenasit. Me këtë veprim, ai ka shkelur nenin 3 të Ligjit Nr. 03/L-072 për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës, i cili ndër të tjera përcakton, "përdorimi i posteve publike, burimeve ose personelit të cilitdo institucioni në nivel qendror ose lokal me qëllim të përkrahjes së subjektit politik në zgjedhje është rreptësishtë i ndaluar.

Subjektet politike nuk mund të shfrytëzojnë nëpunësit civil që përdorin burimet ose personelin përfushatë gjatë zgjedhjeve".

Kërkojnë nga PZAP-i që të nxjerrë vendim me të cilën do të aprovoj si të bazuar ankesën e PDK-së dhe ndaj subjektit politik PDKRL, për shkak të shkeljes së ligjit, t'i shqiptoj dënim me gjobë.

Si provë në ankesë ka bashkangjitur një fotografi, nga postimi në rrjetin social facebook.

Në përgjigjen në ankesë të datës 28.09.2025, të Subjektit Politik PDKRL theksojnë se e kundërshtojnë ankesën e Subjektit Politik PDK, si të pabazuar në prova dhe dispozita ligjore. PDK, pretendon se një person me emrin Mentor Gashi ka bërë një postim në rrjetin social "Facebook" për të ftuar qytetaret të marrin pjesë në një aktivitet politik të Iniciativës Për Drenasin Kampion me Ramiz Lladrovcin. Në ankese thuhet se ky person është "drejtor shkolle", por për këtë nuk është paraqitur asnjë provë.

Më tej në përgjigje Subjekti Politik PDKRL, shtojnë se e njëjta nuk mund të mbahet përgjegjëse për thirrjet e qytetarëve që veprojnë në cilësinë e tyre private pasi që Iniciativa e tyre nuk e ka autorizuar të apostrofuarin për të bërë thirrje për takim elektorial. Për më tepër nga shkrimi i personit të quajtur Mentor Gashi shihet që shkrimi është postuar pas orës 20:00 të datës 26.09.2025, në të njëjtën kohë çdo veprim i tij si person privat nuk do të binte ndesh me paragrafin 3 të nenit 25 të ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtaret Publik edhe sikur të ishte provuar nga pala ankuese se i njëjti mban pozitën për të cilën ankuesi pretendon, e për të cilin pretendim nuk ka bashkangjitur asnjë provë.

Përfundimisht duke pasur parasysh që sipas nenit 117 paragrafi 3 të LZP- se, barra e të provuarit bie mbi ankuesin në të cilin nën thuhet: PZAP me rastin e vendosjes për ankesa mbështetet në dëshmi të qarta dhe bindëse, andaj në rastin konkrete nuk është provuar pozita e personit Mentor Gashi apo shkelja e pretenduar sipas dispozitave ligjore.

Prandaj, bazuar në të Lartcekurat, kërkojnë nga Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa që të nxjerrë këtë:

PZAP-i, pasi që shqyrtoj dhe vlerësoi ankesën gjeti se:

Ankesa është e pa bazuar

Paneli me rastin e shikimit të shkresave të lëndës, vlerësoi se ankesa është e pabazuar pasi që paraqitësi i ankesës nuk ka bashkangjitur asnjë provë si dëshmi, dhe si e tillë nuk mund të vërtetohet se nga ana e drejtorit të shkollës "Bajram Curri" në fshatin Nekoc, si mbështetës i Subjektit Politik PDKRL, është bërë shkelje e nenit 36 paragrafi 1 i Ligjit NR.08/L-228, për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, ku parashihet se *"personi i cili mban pozitë publike i zgjedhur apo i caktuar nuk mund të përdorë atë zyre apo ndonjë nga pasurit e saj me qëllim të përfitimit të votave. Asnjë nga burimet e asnjë institucioni të administratës publike qoftë të nivelit qendror ose lokal ose edhe ndonjë ndërmarrje në zotërim ose të kontrolluar nga autoritetet qendrore ose lokale nuk mund të shfrytëzohet ose të futen në mbështetje të ndonjë subjekti politik në zgjedhje"*.

Parashtresuesi i ankesës Subjekti Politik PDK në ankesën ZLA. nr.71/2025 të datës 27.09.2025, nuk ka bashkangjitur asnjë provë lidhur me shkeljen e pretenduar dhe si e tillë nuk ka mundur të argumentoj në asnjë moment, në mënyrë të qartë dhe bindëse se personi me emrin Mentor Gashi është drejtor në shkollën "Bajram Curri" në fshatin Nekoc, Komuna e Drenasit, e as që është kandidat për anëtarë të kuvendit Komunal të Drenasit, dhe se i njëjti ka bërë shfrytëzimin e pozitës publike, për të zhvilluar fushatë për Subjektin Politik PDKRL, ashtu siç pretendon pala ankuese.

Andaj duke u mbështetur në nenin 117.3 të LZP-së ku përcaktohet se: “vendosja për ankesat nga PZAP-ja mbështetet në dëshmi të qarta dhe bindëse”, Paneli vlerësoj se pretendimet e tilla janë të pa qëndrueshme dhe si të tilla i refuzoj, për faktin se nga veprimet e përshkruara në ankesë parashtruesi i ankesës nuk ka arritur që të vërtetoj se këto veprime që paraqesin shkelje të dispozitave të lartcekura të LZP-së apo të Rregullës Zgjedhore Nr.07/2024, janë bërë pikërisht nga drejtori i shkollës së lartcekur, dhe si të tillë të njëjtën e refuzoi si të pabazuar.

Nga arsyet e theksuar më lartë duke bazuar nenin 117 paragrafi 3, neni 118 paragrafi 1 të LZP-së, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia

ZL.Anr.71/2025 më datë 29.09.2025

Kryesues i Panelit
Kujtim Pasuli



Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 paragrafi 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda dyzet e tetë (48) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.